

# STATUTI

## I SHOQATES SHQIPTARE TE BANKAVE (AAB)

### I.OBJEKTIVAT

#### Neni 1

- 1.1 Shoqata Shqiptare e Bankave është një shoqatë jo-fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. Shoqata Shqiptare e Bankave është organi përfaqësues, i cili në partneritet me aktorët e sektorit publik dhe privat, kontribuon për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të diskutuar çështjet kyçe të industrisë dhe përcaktimin e strategjive të përbashkëta për sektorin financiar shqiptar.
- 1.2 Shoqata Shqiptare e Bankave synon të arrijë objektivat e saj nëpërmjet:
- a) Studimit dhe analizimit të problemeve dhe vështiresive që lidhen me veprimet bankare, si dhe në gjetjen e zgjidhjeve të duhura;
  - b) Bashkëpunimit me organizmat përkatës në drejtim të përmirësimit të aktivitetit bankar si dhe të harmonizimit të tij me legjislacionin e Bashkimit Europian;
  - c) Bashkëpunimit me organizmat kompetente shtetërore duke propozuar projekte që synojnë përmirësimin në legjislacionin shqiptar bankar, si dhe të çdo ligji tjetër, që ndikon drejtpërdrejt ose tërthorazi aktivitetin bankar;
  - d) Vëzhgimit të zhvillimeve bankare në sferën kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe informimit sistematik të anëtarëve të saj mbi këto zhvillime;
  - e) Ndërmjetesimit për zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet anëtarëve të shoqatës;
  - f) Organizimit të takimeve teknike, forumeve, konferencave, seminareve, workshop-eve dhe formave të tjera të edukimit në fushën bankare dhe edukimin financiar.
  - g) Ndërmarrjen e çfarëdo lloji iniciative të lejueshme që shoqata gjykon të nevojshme për arritjen e objektivave të saj.
- 1.3 Asnjë anëtar nuk mund të kryejë ndonjë veprimtari tregtare bankare në emër të Shoqatës.

## II. SELIA

### Neni 2

- 2.1 Selia e Shoqatës Shqiptare të Bankave ndodhet në Rr. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 9, Ap 3, Tiranë.
- 2.2 Logoja zyrtare e shoqatës Shqiptare të bankave është si më poshtë:



## III. KOHEZGJATJA

### Neni 3

- 3.1 Shoqata Shqiptare e Bankave themelohet për një periudhë të pacaktuar kohe dhe mund të shpërndahet në cdo kohë, në përputhje me Nenin 15 të këtij Statuti.

## IV. ANETARESIMI

### Neni 4

- 4.1 Çdo bankë e autorizuar të ushtrrojë aktivitetin e saj në Shqipëri mund t'i deklarojë Sekretariatit qëllimin e saj për t'u bërë anëtare e Shoqatës Shqiptare të Bankave, duke caktuar në këtë rast emrat e përfaqësuesit(ve) të saj në shoqatë. Përfaqësuesit e bankave anëtare mund të jenë vetëm Drejtori Ekzekutiv / Drejtori i Përgjithshëm/Presidenti ose në ndonjë pozicion tjetër të barasvlefshëm me to, në bankat anëtare.
- 4.2 Anëtarësimi në Shoqatën Shqiptare të Bankave është vullnetar. Përfaqësuesi(t) i anëtarit të ri duhet të paraqesë një kërkesë anëtarësimi, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv/Drejtori i Përgjithshëm/Presidenti.
- 4.3 Anëtari i ri është i detyruar të respektojë të gjitha vendimet, rregulloret dhe marrëveshjet e marra nga shoqata përpara anëtarësimit të tij.

## V. NDERPRERJA E ANETARESIMIT

### Neni 5

- 5.1 Cdo anëtar mund të ndërpresë menjëherë anëtarësimin në shoqatë, në rastet e mëposhtme:
- (a) Dorëheqja, duke njoftuar me shkrim Bordin Drejtues,
  - (b) Revokimi i licencës nga Banka e Shqipërisë,
  - (c) Likuidimi,
  - (d) Përrjashtimi, në rastet kur :
    - Anëtarët kryejnë veprime që dëmtojnë aktivitetin ose objektivat e Shoqatës Shqiptare të Bankave;
    - Nuk paguajnë kuotat e anëtarësimit për dy tremujorë rradhazi;
    - Shkelin dispozitat e Statutit të Shoqatës Shqiptare të Bankave.
- 5.2 Anëtari që ka dhënë dorëheqje ose që është përjashtuar duhet të shlyejë gjithë detyrimet financiare të pjesëmarrjes së tyre në shoqatë, deri në datën e dorëheqjes ose atë të përjashtimit nga shoqata.
- 5.3 Anëtari që ka dhënë dorëheqje, është përjashtuar, ose që nuk është më anëtar i shoqatës për çfarëdolloj arsyeje, nuk ka të drejtë të pretendojë ndaj shoqatës apo ndaj pronave të saj.
- 5.4 Ekzistenca dhe vazhdimësia e Shoqatës Shqiptare të Bankave nuk do të ndikohet nga ndryshimet në numrin e anëtarëve të saj.

## **VI. FINANCIMI DHE TE ARDHURAT**

### **Neni 6**

- 6.1 Aktiviteti i Shoqatës Shqiptare të Bankave financohet nga kuotat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të anëtarësimit, si dhe nga interesat që përfitohen prej depozitimit të fondeve në llogarinë bankare të Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Shoqata Shqiptare e Bankave i siguron fondet e nevojshme për realizimin e qëllimit të saj, edhe nëpërmjet praminit të donacioneve nga donatorë vendas e të huaj, financimeve si dhe nga çdo veprimtari e ligjshme që Shoqata Shqiptare e Bankave mund të kyejë jo për qëllim fitimi.

- 6.2 Shoqata Shqiptare e Bankave nuk ka për qëllim të shtojë burimet e saj financiare më tepër se sa nevojitet për kryerjen e aktivitetit të saj.

Kuota e anëtarësimit për bankat, në momentin që ato anëtarësohen në shoqatë, është 120,000 Lekë.

Kuotat e zakonshme të anëtarësisë do të paguhet nga të gjithë anëtarët çdo tre mujor bazuar në përlllogaritjen e bërë sipas buxhetit të aprovuar të vitit konkret, dhe bëhen të pagueshme pas miratimit të tij.

Kuota e zakonshme e anëtarësisë do të llogaritet si me poshte:

Shpenzimet e buxhetuara mbulohen nga anëtarët e Asamblesë në proporcion me përqindjen që zënë asetet e tyre në totalin e aseteve të sistemit bankar (kuotë proporcionale), me një vlerë minimale të kuotave prej 1.000.000 Lek.

- 6.3 Shpenzimet për veprimtari të veçanta të ndërmarra nga Shoqata Shqiptare e Bankave do t`u ngarkohen pjesëmarrësve në këto veprimtari, nëse nga Asambleja e Anëtarëve nuk vendoset ndryshe.
- 6.4 Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.
- 6.5 Mbledhjes së Anëtarëve do t`u paraqitet cdo vit nga revizori, pasqyrat financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave për vitin paraardhës.

## **VII. DREJTIMI I SHOQATES SHQIPTARE TE BANKAVE**

### **Neni 7**

Shoqata përbëhet nga organet drejtuese të poshtëshënuara, të drejtat e të cilëve specifikohen me nenet në vijim

1. Asambleja e Anëtarëve;
2. Bordi Drejtues;
3. Sekretariati;

## **VIII. ASAMBLEJA E ANETAREVE**

### **Neni 8**

- 8.1 Asambleja e Anëtarëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqatës Shqiptare të Bankave. Vetëm përfaqësuesit e caktuar të anëtarëve mund të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Anëtarëve. Në raste të veçanta, përfaqësuesit e autorizuar nëpërmjet një prokure me shkrim, mund të zëvendësojnë përfaqësuesit e caktuar të bankave anëtare.

Vendimet e Asamblese janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e saj, pavarësisht nga vota apo prezenca e tyre në mbledhje. Megjithatë, në asnjë rast Shoqata Shqiptare e Bankave, nuk do të angazhojë asnjë bankë, në rast se vendimi i marrë vjen në kundërshtim me politikën e vetë bankës.

Asambleja e Anëtarëve i zhvillon punimet nën drejtimin e Kryetarit të Shoqatës Shqiptare të Bankave ose Zv/Kryetarit në mungesë të të parit, asistuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës

- 8.2 Asambleja e Anëtarëve është i vetmi organ kompetent i cili mund të marrë vendime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, si më poshtë:

*Vendime të zakonshme*

- (i) Miraton Raportin Vjetor të vitit për vitin e kaluar;
- (ii) Mirat buxhetin dhe planin e biznesit për vitin e ardhshëm;
- (iii) Miraton pasqyrat financiare të audituara të Shoqatës;
- (iv) Pranon anëtarë të rinj;
- (v) Miraton ndërprerjen e anëtarësimit.

*Vendime të jashtëzakonshme*

- (i) Zgjedh Kryetarin, Zv/Kryetarin, dhe tre anëtarët e thjeshtë të Bordit Drejtues, nga përfaqësuesit e caktuar të anëtarëve;
- (ii) Përfshij anëtarët në përputhje me nenin 5 të këtij statuti;

*Vendime të veçanta*

- (i) Vendos për ndryshimet dhe shtesat në Statutin e Shoqatës Shqiptare të Bankave;
- (ii) Vendos për afatet kohore dhe vlerën e kuotës së anëtarësimit, në përputhje me nenin 6 të këtij Statuti;
- (iii) Vendos shpërndarjen e Shoqatës Shqiptare të Bankave.”

- 8.3 Normalisht, Asambleja e Anëtarëve të AAB mbledhet në baza të zakonshme, dy herë në çdo vit kalendarik. Asambleja e Anëtarëve thirret nga Kryetari ose Bordi Drejtues, nëpërmjet Sekretariatit.
- 8.4 Asambleja mund të thirret gjithashtu në çdo kohë, kur gjykohet e nevojshme, në mënyrë të jashtëzakonshme nga Kryetari, Bordi Drejtues, ose me kërkesë të të paktën 1/5 të anëtarëve të Asamblesë.
- 8.5 Si rregull, rendi i ditës për mbledhjen u dërgohet anëtarëve të paktën pesë ditë para datës së mbledhjes. Megjithatë, për çështje urgjente, rendi i ditës mund të dërgohet në çdo kohë, para mbledhjes, por në këtë rast, vendimi i marrë mbi këtë rend dite do të konsiderohet si vendim i jashtëzakonshëm.
- 8.6 Çdo anëtar i shoqatës ka të drejtë të propozojë çështje në rendin e ditës. Propozimet do të depozitohen pranë Sekretariatit të Shoqatës të paktën 3 (tre) ditë kalendarike përpara datës së mbledhjes. Çështjet e propozuara gjatë mbledhjeve të Asamblesë do të përfshihen automatikisht në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme, përveç kur Asambleja vendos ndryshe nga mënyra e zakonshme e marrjes së vendimeve

## **IX. VENDIMET E ASAMBLESE SE ANETAREVE**

## Neni 9

- 9.1 Çdo anëtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave ka të drejtën e një vote në Asamblenë e Anëtareve.
- 9.2 Asambleja e Anëtarëve mund të marrë vendime të zakonshme, të jashtëzakonshme ose të veçanta me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- 9.3 Asambleja e Anëtarëve është e autorizuar të marrë vendime të vlefshme të zakonshme kur janë të pranishëm të paktën 1/2 e anëtarëve të Shoqatës Shqiptare të Bankave.”

Në qoftë se ky kuorum nuk arrihet, një mbledhje e dytë do të mbahet, të paktën një javë më vonë.

Asambleja e thirrur për herë të dytë është në gjendje të marrë vendime të zakonshme me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

- 9.4 Asambleja e Anëtarëve mund të marrë vendime të vlefshme të kur janë të pranishëm të paktën 2/3 e anëtarëve të Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Në qoftë se ky kuorum nuk arrihet, një mbledhje e dytë do të mbahet të paktën një javë më vonë.

Asambleja e thirrur për herë të dytë është në gjendje të marrë vendimetë jashtëzakonshme me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

- 9.4(1) Asambleja e Anëtarëve mund të marrë vendime të veçanta të vlefshme me shumicë të thjeshtë vote të të gjithë anëtareve të shoqatës.

Nëse ky kuorum nuk arrihet, një mbledhje e dytë do të mbahet të paktën një javë më vonë.

Asambleja e thirrur për herë të dytë është në gjendje të marrë vendime të veçanta bazuar në pikën 9.4 të këtij neni.

- 9.5 Votimi me anë të prokurës u lejonet vetëm përfaqësuesve të caktuar, të autozizuar me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv/Drejtori i Përgjithshëm apo çdo pozicion i barazvlefshëm me to, të bankës anëtare të Shoqatës.

## X. BORDI DREJTUES

## Neni 10

10.1 Bordi Drejtues i Shoqatës Shqiptare të Bankave zgjidhet nga Asambleja e Anëtarëve. Të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues duhet të jenë Drejtorë të Përgjithshëm/Drejtorë Ekzekutivë në bankat e tyre ose në një pozicion të njëjtë menaxhues në bankën e tyre.

Bordi Drejtues përbehet nga 5 (pesë) anëtarë, tre nga të cilët do të zgjidhen nga gjashtë bankat me perqindjen më të lartë të asetëve në totalin e asetëve të sistemit bankar, dhe dy anëtarët e tjerë do të zgjidhen nga bankat e tjera anëtare.

Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave do të zgjidhen ndërmjet anëtarëve të Bordit Drejtues.

10.1(1) Në rastet e mungesës së kandidatëve në njerin nga grupet e bankave anëtare të përmendura më lart, kandidatët nga grupi tjetër do të kenë të drejtën të zgjidhen për vendet vakante në Bordin Drejtues.

Kandidatura për Bordin Drejtues dhe/ose tërheqja e saj duhet të paraqitet në Sekretariatit e AAB-së, jo më vonë se 3 (tre) ditë pune përpara datës së Mbledhjes së Asamblesë. Në qoftë se numri i kandidaturave të paraqitura brenda këtij afati është më i vogël ose i njëjtë me numrin e vendeve të lira në Bordin Drejtues, paraqitja e kandidaturave do të pranohet edhe pas këtij afati.

10.2 Çdo anëtar i Bordit Drejtues qëndron në detyrë për një periudhë dy vjeçare dhe mund të rizgjidhet për periudhën pasardhëse. Bordi Drejtues, sipas rastit, ka të drejtë të kooptojë anëtar(ë) të rinj, të cilët do të qëndrojnë në detyrë deri në mbledhjen më të afërt të Asamblesë. Në këtë mbledhje Asambleja do të zgjedhë anëtarin(ët) e rinj të Bordit Drejtues.

10.3 Bordi Drejtues ka kompetencat e mëposhtme:

- a) Përmbush funksione dhe detyra specifike, siç udhëzohet nga Asambleja;
- b) Thërret Asamblenë e Anëtarëve në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, përcakton rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e tyre;
- c) Emëron Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin e Sekretariatit, përcakton shpërblimet përkatëse për to, dhe u dërgon një kopje të CV-së së tyre të gjithë anëtarëve të Shoqatës;
- d) I rekomandon Asamblesë iniciativa të ndryshme dhe masa në favor të anëtarëve të Shoqatës Shqiptare të Bankave;
- e) Informon menjëherë anëtarët e Shoqatës Shqiptare të Bankave nëpërmjet Sekretariatit, për çdo ndryshim dhe zhvillim të rëndësishëm të aktivitetit bankar në vend;
- f) Shqyrton dokumentacionin për pranimin e anëtarëve të rinj, në përputhje me nenin 4 të këtij statuti,
- g) Zbaton buxhetin dhe planin e biznesit për vitin në vijim, nëpërmjet Sekretariatit.

- 10.4 Vendimet e Bordit Drejtues merren me shumicë të thjeshtë votash. Kuorumi përbëhet prej 4 anëtarësh. Në rast barazie votash, vota e Kryetarit do të jetë e vlefshme për dy vota.

Vendimet e Bordit mund të merren në mënyrë të vlefshme gjithashtu nëpërmjet telefonit, faksit, e-mail-it etj. Sekretariati i Shoqatës do të informohet për të gjitha vendimet e marra nga Bordi Drejtues, në mënyrë që të njoftojë menjëherë të gjithë anëtarët e tjerë të Shoqatës Shqiptare të Bankave mbi këto vendime.

- 10.5 Bordi Drejtues mund të krijojë komisione të veçanta dhe të ftojë konsulentë të posaçëm në mbledhjet e Bordit Drejtues dhe ato të Asamblesë së Anëtarëve.
- 10.6 Bordi Drejtues duhet të sigurojë zbatimin e duhur të buxhetit dhe planit të biznesit të Sekretariatit. Të gjitha veprimet bankare në emër dhe për llogari të Shoqatës Shqiptare të Bankave do të realizohen me firmë të përbashkët të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshilltarit Ligjor. Në rast të mungesës së njërit prej tyre, Kryetari ose Zëvendës Kryetari mund t'i delegojnë të drejtën e firmës çdo punonjësi të punësuar me kohë të plotë pranë shoqatës.
- 10.7 Kryetari i Shoqatës, ose në mungesë të tij Zv/Kryetari do të përfaqësojë i vetëm Shoqatën Shqiptare të Bankave ndaj palëve të treta. Ai mund t'u delegojë me shkrim, pjesërisht ose tërësisht kompetencat e tij Sekretarit të Përgjithshëm, ose personave të zgjedhur prej tij, midis anëtarëve të Bordit Drejtues.

## **XI. SEKRETARIATI**

### **Neni 11**

- 11.1 Sekretariatit i besohet drejtimi i përditshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave, i cili raporton tek Bordi Drejtues.

Detyrat dhe kompetencat e Sekretariatit i cili drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, konsistojnë në:

- a) Zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Anëtarëve,
- b) Njoftimin e anëtarëve për vendimet e marra nga Asambleja si dhe nga Bordi Drejtues, gjithashtu dhe përmbushjen e këtyre vendimeve,
- c) Përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga Bordi Drejtues,
- d) Përfaqësimin e Shoqatës tek autoritetet shtetërore, në gjykatë dhe ndaj palëve të treta (nëpërmjet prokurës), në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar,
- e) Zbatimin e buxhetit vjetor dhe planit të biznesit,
- f) Përgatitjen e informacionit që do të publikohet nga shoqata dhe paraqitjen e këtij të fundit Bordit Drejtues.
- g) Mbledhjen e kuotave të anëtarësisë,
- h) Mbikqyrjen e llogarisë së shoqatës dhe bashkëpunimin me Audituesin,
- i) Përgatitjen dhe firmosjen e pasqyrave financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave.



- 11.2 Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi tjetër i Shoqatës emërohen nga Bordi Drejtues.
- 11.3 Sekretariati ka për detyrë të regjistrojë mbledhjet e Asamblesë, si dhe të përgatisë procesverbalin, duke u konsultuar me Kryetarin, për shpërndarjen dhe aprovimin e tij nga anëtarët. Anëtarët duhet të kthejnë përgjigje brenda 5 ditëve pune. Ky proces verbal i aprovuar do të firmoset më pas nga Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm. Sekretariati shpërndan gjithashtu edhe rendin e ditës.

## **XII. REVIZORI**

### **Neni 12**

- 12.1 Sekretari i Përgjithshëm do të përzgjedhë dhe kontrakttojë një Auditor të licensuar
- 12.2 Auditori do të kontrollojë pasqyrat financiare, të cilat do të përgatiten nga Sekretariati i shoqatës. Pasqyrat financiare të audituara dhe do t'i paraqiten Bordit Drejtues dhe Asamblesë së Anëtarëve.

## **XIII. RREGULLAT E BRENDSHME**

### **Neni 13**

- 13.1 Asambleja e Anëtarëve, me propozim të Bordit Drejtues, mund të miratojë dhe aprovojë rregullore dhe akte të tjera rregullative, në përputhje me këtë Statut, në mënyrë që të sigurojë funksionimin e aktivitetit të Shoqatës.

## **XIV. SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI**

### **Neni 14**

- 14.1 Shoqata Shqiptare e Bankave mund të shpërbëhet, në çdo kohë, nga Asambleja e Anëtarëve.
- 14.2 Në rast shpërbërjeje vullnetare, Asambleja e Anëtarëve cakton likujduesin(it) dhe përcakton kompetencat e tij/tyre.
- 14.3 Në rast shpërbërjeje, qoftë kjo vullnetare ose gjyqësore, mjetet e Shoqatës Shqiptare të Bankave, në çdo kohë dhe për çfarëdolloj arsyeje, do të transferohen në përputhje me qëllimet e Asamblesë së Anëtarëve, duke marrë parasysh se këto mjete mund të transferohen vetëm në favor të ndonjë shoqatë e cila ndjek objektiva jo-fitimprurëse.

## **XV. DISPOZITA TE FUNDIT**

Ky statut u nënshkrua nga përfaqësuesi i secilës bankë anëtare e Shoqatës Shqiptare të Bankave, në prezencë të Noterit.

**Statuti i përditësuar - Qershor 2018**